

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-105/14

Prishtinë
9 Mars 2016

Në çështjen juridike të:

L.B.

Dardania SU -9/4

Hyrja 4, Bodrum

Prishtinë

Pala ankuese

kundër

R.J. (përfaqësues i autorizuar i V.A.)

Bosce, Kamenica/Kamenicë

Kosovo

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Beshir Islami dhe Anders Cedhagen, gjyqtarë, duke vendosur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/224/2013 të datës 27 nëntor 2013

(lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA00151), pas shqyrtimit të mbajtur më 9 Mars 2016, mori këtë:

AKTGJYKIM

- 1. Hidhet poshtë si e papranueshme ankesa e L.B. t, e paraqitur kundër vendimit KPCC/D/C/224/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA00151), të datës 27 nëntor 2013.**

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 18 Janar 2007, V.A. (në tekstin e mëtejshëm: paraqitësi i kërkesës), ka paraqitur një kërkesë pranë Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar ri-posedimin e objektit afarist (vend magazinimi) me hapësirë prej 43.64 m² në adresën rruga “Nikola Pašica” BB lagjja “Bela Česma/Kroi i bardhë, nr.14 në Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: pronë e kërkuar).
2. Me kërkesën e tij ai ka dorëzuar në mes tjerash edhe dokumentet vijuese:
 - Kontratën për ndërtimin e hapësirës për vend magazinimi Nr.02-2828/1 e datës 22 Nëntor 1996 të lidhur mes Ndërmarrjes Publike Banesore në Prishtinë dhe paraqitësit të kërkesës.
 - Fakturën e datës 22 Nëntor 1996 të lëshuar nga Ndërmarrja Publike Banesore sipas të cilës paraqitësi i kërkesës kishte paguar 50 % nga vlera e parashikuar për pronën e kërkuar sipas kontratës 02-2828/1.
 - Fakturën Nr. 2828/96 të datës 16 Dhjetor 1996 të lëshuar nga Ndërmarrja Publike Banesore sipas të cilës paraqitësi i kërkesës kishte paguar 20 % nga vlera e parashikuar për pronën e kërkuar sipas kontratës 02-2828/1.
 - Fakturën Nr. 2828/97 të datës 11 Prill 1997 të lëshuar nga Ndërmarrja Publike Banesore sipas të cilës paraqitësi i kërkesës kishte paguar 30 % nga vlera e parashikuar për pronën e kërkuar sipas kontratës 02-2828/1.

- Fakturën e datës 17 mars 1998 të lëshuara nga Ndërmarrja Publike Banesore në Prishtinë me të cilën paraqitësi i kërkesës kishte paguar shumën prej 752 000 dinarë (valutë serbe) për pronën e kërkuar sipas Kontratës Nr.02-2828/1 të datës 22 Nëntor 1996.
 - Fakturën e datës 23 prill 1998 e lëshuar nga Ndërmarrja Publike Banesore në Prishtinë me të cilën paraqitësi i kërkesës kishte paguar shumën totale për pronën e kërkuar sipas kontratës Nr.02-2828/1 të datës 22 nëntor 1996.
 - Aneks Kontratën Nr. 02-1125/1 e lidhur me datën 22 maj 1998 mes Ndërmarrjes Publike Banesore në Prishtinë dhe paraqitësit të kërkesës përmes të cilës ndryshohet neni 3 dhe neni 4 i kontratës Nr. 02-2828/1.
 - Letër Konfirmimin Nr.02-1125/8 të lëshuar nga Ndërmarrja Publike Banesore në Prishtinë me datën 22 maj 1998 përmes të cilës konfirmohet se paraqitësi i kërkesës ka blerë pronën e kërkuar sipas kontratës Nr.02-2828 të datës 22 Nëntor 1996.
 - Procesverbalin Nr.02-1253/2 te datës 15 korrik 1998 në lidhje me pranim dorëzimin e çelësave në lidhje pronën e kërkuar .
 - Autorizimin Nr. 1221/2002, te vërtetuar në Gjykatën Komunale të Kamenicës me datën 21 dhjetor 2002 përmes të cilës V.A. e autorizon R.J. që ta përfaqësojë para institucioneve relevante ne lidhje me pronën e kërkuar.
3. Të gjitha dokumentet e lartcekura janë verifikuar pozitivisht nga AKP.
 4. Identifikimi i pronës së kërkuar fillimisht ishte bërë me 20 qershor 2007.Raporti i identifikimit përshkruante pronën si vend magazinim i pa uzurpuar. Megjithatë, sipas shkresave në dosje, L.B. ishte paraqitur si palë e interesuar. Fillimisht ajo kishte deklaruar se pronën e kërkuar e kishte marrë në posedim dhe kishte pretendim ligjor ndaj pronës (faqe 106 në dosje) pastaj ajo kishte deklaruar se nuk pretendon të drejtë ligjore ndaj pronës së kërkuar (faqe 105 dhe 216 në dosje).
 5. AKP-ja ri- identifikoi pronën me datën 25 janar 2013.Gjatë procesit të identifikimit ku mori pjesë edhe paraqitësi i kërkesës, prona e kërkuar u gjet të jetë e uzurpuar nga person i paidentifikuar.
 6. Pasi që asnjë palë nuk kishte paraqitur përgjigjeje brenda afatit prej 30 ditësh të paraparë me nenin 10.2 të Ligjit nr. 03/L-079, kërkesa u konsiderua si e pa-kontestuar.
 7. KKPK aprovoi kërkesën me Vendimin KPPC/D/C/224/2013 të datës 27 nëntor 2013.

8. Vendimi iu dorëzua L.B. t më 6 shkurt 2014. Më 5 mars 2014, ajo paraqiti një ankesë kundër vendimit.

Pretendimet e palës ankuese:

9. Pala ankuese pohon se prona e kërkuar nuk është prona ku ajo jeton. Ajo deklaron se prona e kërkuar ndodhet përballë objektit ku ajo jeton. Me ankesë ajo i referohet vërtetimit jo të plotë të fakteve dhe kërkon verifikimin e gjendjes faktike.

Arsyetim ligjor:

Juridiksioni

10. Gjykata Supreme ka juridiksion për ta shqyrtuar ankesën.

Pranueshmëria e ankesës

11. Ankesa është e papranueshme sepse është paraqitur nga një person që nuk ka qenë palë në procedurë në shkallën e parë para KKPK-së.
12. Sipas nenit 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079, një palë mund të paraqes një ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh që nga njoftimi i palëve nga ana e Agjencisë Kosovare të Pronës rreth vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore.
13. Neni 10.1 i Ligjit nr. 03/L-079 parasheh që pas pranimit të kërkesës, Sekretaria Ekzekutive do ta njoftojë dhe dërgojë një kopje të kërkesës çdo personi përveç paraqitësit të kërkesës i cili aktualisht ushtron ose pretendon se ka të drejtë në pronën e cila është objekt i kërkesës. Neni 10.2 i së njëjtës parasheh që *“çdo person përveç paraqitësit të kërkesës i cili aktualisht ushtron ose pretendon se ka të drejtë në pronën e cila është objekt i kërkesës dhe/ose çdo person i cili mund të ketë ndonjë interes ligjor në pronën e kërkuar do të jetë palë ... me kusht që personi i tillë ta informojë Sekretarinë ekzekutive për qëllimin e tij që të marrë pjesë në procedurën administrative brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi për kërkesën nga Sekretaria ekzekutive [...]”*.
14. Vetëm pala në procedurën e shkallës së parë ka të drejtën e paraqitjes së ankesës kundër Vendimit të KKPK-së. Sipas praktikës së Kolegjit të Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme,

i vetmi përjashtim ndaj këtij rregulli shfaqet nëse personi i cili mund të kërkojë një të drejtë mbi pronën e kontestuar nuk ka pasur njohuri se kërkesa është paraqitur në AKP për shkak të njoftimit joadekuat dhe rrjedhimisht nuk është në gjendje të paraqes njoftimin e pjesëmarrjes gjatë zhvillimit të procedurës në shkallën e parë.

15. Në rastin konkret, Gjykata Supreme vëren se pala ankuese ka qenë në dijeni për procedurën në lëndën KPA00151 pasi që ajo personalisht është njoftuar më 13 korrik 2007. Megjithatë, ajo nuk ka kërkuar ndonjë të drejtë ligjore mbi pronën e kërkuar, që është objekt shqyrtimi (faqe 105 dhe 213 e dosjes). Ajo gjithashtu nuk ka paraqitur njoftimin e pjesëmarrjes sikurse kërkohet me nenin 10.2 të Ligji nr. 03/L-079. Gjykata Supreme vëren se identifikimi i pronës së kërkuar është bërë si duhet, për me tepër personalisht paraqitësi i kërkesës kishte marrë pjesë gjatë procesit të identifikimit në lidhje me pronës së kërkuar. Pasi që pala ankueses kishte deklaruar se nuk ka kërkuar ndonjë interes ligjor ndaj pronës së kërkuar, ajo tani nuk ka legjitimitetin që të paraqes ankesë pranë Gjykatës Supreme kundër Vendimit të shkallës së parë.
16. Megjithatë, Gjykata Supreme e sheh të dobishme të theksoj së objekti i shqyrtimit në kërkesën KPA00151 ka të bëjë me një vend magazinimi me sipërfaqe prej 43.64 m² në adresën Kroi i Bardhe no.14 në Prishtinë, dhe jo me objekt banimit ku pala ankuese pretendon se është duke jetuar.
17. Pasi që ankesa nuk është e pranueshme, Gjykata Supreme nuk e ka detyrim të vendos mbi meritat e ankesës.
18. Ankesa duhet të hidhet poshtë si e papranueshme sipas nenit 12.1 dhe 13.3 (b) të Ligjit nr. 03/L-079 dhe nenit 195.1 nën-paragrafi (a) i Ligjit të Procedurës Kontestimore. Prandaj, Kolegji i Apelit të AKP-se ka vendosur sikurse në dispozitiv.
19. Ky aktgjykim nuk e paragjykon të drejtën e palës ankuese për të kërkuar të drejtën e saj të pretenduar pranë gjykatës kompetente nëse e konsideron të nevojshme.

Këshillë ligjore

20. Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit

Beshir Islami , Gjyqtarë

Anders Cedhagen, Gjyqtar i EULEX-it

Sandra Gudaityte , Referent i EULEX-it